

#PDK130

**BASHKË.
PËRPARA.**

**PROGRAMI ELEKTORAL
2025**

HYRJE

I. EKONOMIA

II. PAGAT, PENSIONET DHE MIRËQENIA SOCIALE

III. ENERGJIA

IV. MBROJTJA E AMBIENTIT

V. DREJTËSIA

VI. SHËNDETËSIA

VII. ARSIMI

VIII. KULTURA, RINIA DHE SPORTI

IX. SIGURIA

POLITIKA E JASHTME

PËRMBYLLJE

Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës,
28 dhjetor 2025

HYRJE

Kosova sot ndodhet në një moment vendimtar të historisë së saj politike, ekonomike dhe shoqërore. Pas më shumë se dy dekadash shtetndërtim, vendi ynë ka dëshmuar se ka kapacitet për të përballuar sfida të mëdha dhe për të ecur me hapa të mëdhenj përpara.

Por, sot po përballlet me pengesa serioze që po e ngadalësojnë përparimin dhe po e rëndojnë jetën e qytetarëve.

Sot, Kosova ka nevojë të qartë për **zhvillim ekonomik të qëndrueshëm**, që nuk mbetet vetëm në statistika, por reflektohet drejtpërdrejt në jetën e përditshme të qytetarëve. Ka nevojë për paga që mjaftojnë për të jetuar me dinjitet, për pensione më të sigurta, për kosto të përballueshme të jetesës dhe për mundësi reale punësimi, veçanërisht për të rinjtë.

Kosova ka po ashtu nevojë për **stabilitet politik dhe institucional**. Asnjë shtet nuk mund të zhvillohet në kushtet e pasigurisë së vazhdueshme, të krizave politike dhe të përçarjeve të thella shoqërore. Institucionet duhet të jenë funksionale, vendimarrja e parashikueshme dhe qeverisja e përgjegjshme. Vetëm kështu krijohet besim te qytetarët dhe siguri për investimet dhe zhvillimin.

Një tjetër nevojë thelbësore është **integrimi i plotë euroatlantik**. E ardhmja e Kosovës është e lidhur ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe botën demokratike perëndimore. Për këtë, Kosova ka nevojë për diplomaci serioze, për partneritete të forta dhe për një politikë të jashtme të qëndrueshme, që e rrit kredibilitetin e shtetit në arenën ndërkombëtare.

Sfida kryesore e Kosovës nuk është mungesa e potencialit. Kosova ka njerëz punëtorë, profesionistë të aftë, sipërmarrës të guximshëm dhe një rini me energji e talent. Ajo që ka munguar në këto vitet e fundit është **bashkimi rreth interesit të përbashkët shtetëror**.

Përçarja politike, mungesa e bashkëpunimit dhe polarizimi shoqëror kanë krijuar një ambient ku potenciali i vendit nuk është shfrytëzuar dhe zhvillimi ka ngecur. Shteti përparon kur ka bashkëpunim për të ecur në të njëjtin drejtim, jo kur ka përçarje e përjashtim.

Prandaj, **bashkimi** është pjesa që ka munguar në mozaikun e Kosovës. Pa bashkim nuk ka stabilitet. Pa stabilitet nuk ka zhvillim. Pa zhvillim nuk ka mirëqenie.

Ky program nuk është një listë premtimesh të shkëputura, por **një plan qeverisës i plotë**, i ndërtuar mbi analiza reale, masa konkrete dhe përgjegjësi institucionale. Është një program që synon ta rikthejë stabilitetin politik, ta përshpejtojë zhvillimin ekonomik dhe ta forcojë shtetin ligjor, duke i vendosur qytetarët dhe familjet kosovare në qendër të politikave publike.

Por, mbi të gjitha, ky program është një **ftesë për bashkim**.

Një ftesë për dialog, për konsensus dhe për ecje të përbashkët përpara.

Sepse, vetëm duke ecur **bashkë**, mund të ecim përpara.



**BASHKË.
PËRPARA.**



I. EKONOMIA

I. EKONOMIA

Zhvillimi ekonomik është kushti themelor për mirëqenien e qytetarëve, stabilitetin shoqëror dhe forcimin e shtetit. Një ekonomi që nuk rritet në mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme prodhon pabarazi, pasiguri dhe varfëri. Për këtë arsye, politika ekonomike duhet të jetë e përgjegjshme, e parashikueshme dhe e orientuar drejt interesit të qytetarëve dhe familjeve.

Qëllimi i programit ekonomik të Qeverisë së udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës është ndërtimi i një ekonomie funksionale, konkurruese dhe gjithëpërfshirëse, ku rritja ekonomike reflektohet drejtpërdrejt në rritjen e pagave, pensioneve dhe cilësisë së jetës.

1.1 Reforma fiskale dhe drejtësi tatimore

PDK angazhohet për një sistem fiskal të drejtë, progresiv dhe stimulues për zhvillimin ekonomik.

Të ardhurat mujore deri në **400 euro** do të jenë **tërësisht të liruara nga tatimi**, me qëllim mbrojtjen e shtresave me të ardhura të ulëta dhe përballimin e kostos së jetesës.

Të ardhurat mujore nga **400 deri në 800 euro** do të taten me normën **8%**, ndërsa të ardhurat mbi **800 euro** me normën **10%**, duke vendosur një sistem progresiv që rrit drejtësinë sociale dhe mbron shtresën e mesme.

Ligji aktual për **tatimin në pronë do të shfuqizohet**, pasi ka krijuar barrë të panevojshme financiare për familjet dhe bizneset.

Politika tatimore do të riformulohet në mënyrë që të jetë e drejtë, e përbalueshme dhe e qëndrueshme.

1.2 Ndryshime në praktikat e pagesës së TVSH-së

Qeveria e udhëhequr nga PDK do të aplikojë normë **0% të TVSH-së për produkte esenciale të shportës bazë**, me qëllim uljen e menjëhershme të çmimeve dhe mbrojtjen e fuqisë blerëse të qytetarëve.

Për bizneset, një nga pengesat kryesore është pagesa e TVSH-së në kufi për mallrat e importuara. Qeveria e PDK-së do ta ndryshojë këtë praktikë, duke e **transferuar pagesën e TVSH-së në brendësi të Kosovës** dhe pas shitjes së produkteve, jo si deri më tani në momentin e importit.

Kjo masë:

- përmirëson likuiditetin e bizneseve,
- ul presionin financiar,
- rrit qarkullimin ekonomik,
- krijon kushte më të favorshme për investime dhe punësim.

Ilogaridhënies në ndërmarrjet publike, pa cenuar interesin publik.

Listimi do të jetë i pjesshëm dhe i kontrolluar, pa cenuar pronësinë publike dhe pa rrezikuar asetet strategjike të shtetit, duke synuar rritjen e transparencës dhe efikasitetit të menaxhimit.

1.3 Mbështetja për bizneset e vogla dhe të mesme

Bizneset e vogla dhe të mesme janë shtylla kryesore e ekonomisë së Kosovës dhe gjeneruesit kryesorë të vendeve të punës.

Bizneset me qarkullim vjetor deri në **10,000 euro** do të lirohen nga tatimi, për të nxitur formalizimin, sipërmarrjen dhe rritjen e aktivitetit ekonomik. Ndërsa, ato me qarkullim **deri në 30 mijë do të paguajnë tatim vetëm mbi fitimin real.**

Për investimet mbi **500,000 euro** ose investimet që krijojnë mbi **50 vende të reja pune**, do të ofrohen **lehtësira të përkohshme tatimore**, si instrument për tërheqjen e investimeve strategjike dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

1.4 Qasja në financa dhe mbështetja për investime

Qasja e kufizuar në financa mbetet një nga pengesat kryesore për zhvillimin e bizneseve vendore.

PDK angazhohet për:

- zgjerimin e Fondit të Garantimit të Kredive, për të ulur rrezikun dhe normat e interesit.
- subvencione dhe grante që mbulojnë deri në **30% të shumës së investimit**, veçanërisht për sektorët prodhues dhe inovativë. Këto grante dhe instrumente mbështetëse do të administrohen përmes **thirrjeve publike transparente**, me kritere të qarta për përfitim, monitorim të rregullt dhe vlerësim të ndikimit ekonomik.
- krijimin e instrumenteve të reja financiare për bizneset e reja dhe startup-et.

1.5 Themelimi i Bursës së Kosovës

Për të modernizuar sistemin financiar dhe për të krijuar burime të reja financimi, do të themelohet **Bursa e Kosovës.**

Bursa do të:

- rrisë transparencën financiare,
- mobilizojë kapitalin vendor,
- krijojë alternativa të reja financimi për ndërmarrjet,
- dhe do ta afrojë Kosovën me standardet evropiane të tregjeve financiare.

1.6 Rritja e eksporteve dhe konkurrueshmërisë

Deficiti i lartë tregtar është një nga problemet strukturore të ekonomisë së Kosovës.

Qeveria e PDK-së do të:

- themelojë **Agjencinë për Promovimin e Eksporteve**,
- mbështesë prodhuesit vendorë në certifikim, standardizim dhe depërtim në tregje të huaja,
- përdorë diplomacinë ekonomike për hapjen e tregjeve të reja,
- zhvillojë zona të lira ekonomike për prodhim dhe eksport.

1.7 Infrastruktura si motor i zhvillimit ekonomik

Zhvillimi ekonomik kërkon infrastrukturë moderne dhe funksionale.

PDK angazhohet për:

- përfundimin e projekteve madhore rrugore,
- zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore,
- veçanërisht **lidhjen hekurudhore Kosovë–Shqipëri**, si projekt strategjik ekonomik dhe kombëtar.

1.8 Legalizimi i ndërtimeve dhe aktivizimi i kapitalit të bllokuar

Legalizimi i ndërtimeve do të realizohet me **tarifë simbolike**, duke e futur kapitalin e bllokuar në qarkullim ekonomik.

Kjo masë:

- aktivizon miliarda euro pasuri të paluajtshme,
- zgjeron bazën tatimore,
- krijon mundësi të reja investimi dhe zhvillimi.

1.9 Reforma e ndërmarrjeve publike

Ndërmarrjet publike do të reformohen për t'u shndërruar në institucione funksionale, transparente dhe financiarisht të qëndrueshme.

Qëllimi është që ato të mos jenë barrë për buxhetin e shtetit, por faktor aktiv i zhvillimit ekonomik dhe punësimit.

Qeveria e PDK-së do të krijojë bazën ligjore dhe institucionale për **përfshirjen graduale të ndërmarrjeve publike në tregun e letrave me vlerë**, përmes listimit të pjesshëm në Bursën e Kosovës. Kjo masë synon rritjen e transparencës,

përmirësimin e qeverisjes korporative, mobilizimin e kapitalit dhe forcimin e llogaridhënies në ndërmarrjet publike, pa cenuar interesin publik.

Listimi do të jetë **i pjesshëm dhe i kontrolluar**, pa cenuar pronësinë publike dhe pa rrezikuar asetet strategjike të shtetit, duke synuar rritjen e transparencës dhe efikasitetit të menaxhimit.



A large, semi-transparent blue hand is shown holding a small group of stylized human figures. The figures are also blue and appear to be walking or standing together. The background is a gradient of blue and purple.

II. PAGAT, PENSIONET DHE MIRËQENIA SOCIALE

II. PAGAT, PENSIONET DHE MIRËQENIA SOCIALE

Mirëqenia sociale është treguesi më i drejtpërdrejtë i suksesit të një qeverie. Një shtet që synon stabilitet dhe zhvillim të qëndrueshëm duhet të sigurojë që rritja ekonomike të reflektohet realisht në jetën e qytetarëve, veçanërisht për ata që varen nga paga apo pensioni.

Në vitet e fundit, rritja e çmimeve dhe kostos së jetesës nuk është shoqëruar me rritje të mjaftueshme të të ardhurave. Kjo ka krijuar presion të madh mbi familjet, ka ulur fuqinë blerëse dhe ka rritur pasigurinë sociale. Për këtë arsye, Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike të Kosovës do të ndërmarrë masa të qarta dhe të matshme për përmirësimin e mirëqenies ekonomike dhe sociale.

2.1 Rritja e pagave në sektorin publik - Vlerësim për shërbimin ndaj qytetarëve

Qeveria e PDK-së angazhohet për **rritje prej 50% të pagave në sektorin publik**, si masë e domosdoshme për të ruajtur dinjitetin e punës publike dhe për të përmirësuar standardin e jetesës së punonjësve.

Kjo rritje do të zbatohet në mënyrë të planifikuar dhe të qëndrueshme, duke përfshirë mësimdhënësit, stafin shëndetësor, administratën publike, shërbimet e sigurisë dhe sektorët e tjerë publikë. Rritja e pagave synon jo vetëm përmirësimin e mirëqenies së punonjësve, por edhe rritjen e motivimit, profesionalizmit dhe cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët.

Një sektor publik i vlerësuar dhe i paguar dinjitetshëm është parakusht për një shtet funksional dhe të besueshëm.

2.2 Rritja e pensioneve dhe ndihmave sociale - Siguri ekonomike për të moshuarit dhe kategoritë në nevojë

PDK angazhohet për rritje prej **50% të pensioneve dhe ndihmave sociale**, me qëllim që asnjë pension apo përfitim social të mos jetë më i ulët se **250 euro në muaj**.

Kjo masë synon mbrojtjen e pensionistëve dhe përfituesve të ndihmës sociale nga varfëria dhe pasiguria ekonomike. Rritja e pensioneve dhe ndihmave sociale do të sigurojë një minimum jetik dinjitoz dhe do të kontribuojë në stabilitetin social dhe solidaritetin shoqëror.

Sistemi social do të bazohet në parimet e drejtësisë, transparencës dhe qëndrueshmërisë buxhetore.

PDK-ja nderon sakrificat e mëdha të luftëtarëve tanë të lirisë dhe familjeve të tyre dhe jemi të angazhuar për t'u siguruar atyre dhe familjeve të tyre mbështetjen dhe respektin që meritojnë.

- Përfitimet e të gjitha kategorive të luftës, duke përfshirë familjet e dëshmorëve, veteranët dhe invalidët e luftës, do të rriten për 50 %;
- Prindërit e familjeve të dëshmorëve nuk do të duhet të zgjedhin ndërmjet pensionit të moshës dhe pensionit të familjes së dëshmorit, por do t'i përfitojnë të dy llojet e pensioneve;
- Do t'i heqim kufizimet për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfitues të pensionit të veteranit, që të jenë aktivë në tregun e punës.

2.3 Shtesa mujore për fëmijët - Investim i drejtpërdrejtë në familje dhe të ardhmen

Qeveria e PDK-së do të zbatojë **shtesë mujore prej 50 euro për çdo fëmijë deri në moshën 16 vjeçare**, si politikë universale për mbështetjen e familjeve.



Kjo shtesë synon të ndihmojë familjet në përballimin e shpenzimeve të përditshme për ushqim, arsim, shëndetësi dhe aktivitete zhvillimore për fëmijët. Njëkohësisht, kjo politikë përfaqëson investim afatgjatë në zhvillimin njerëzor dhe në të ardhmen e Kosovës.

Mbështetja për fëmijët është mbështetje për shoqërinë në tërësi.

2.4 Përkrahja për lehonat dhe familjet e reja

PDK do të zbatojë politika të posaçme për **përkrahjen e lehonave**, duke mbrojtur nënat e reja, familjet e tyre dhe njëkohësisht punëdhënësit.

Këto politika do të përfshijnë mbështetje financiare për lehonat, mekanizma që garantojnë ruajtjen e vendit të punës dhe ndarje të drejtë të përgjegjësisë ndërmjet shtetit dhe sektorit privat. Qëllimi është që lehonat të mos perceptohen si barrë financiare, por si kontribut i rëndësishëm shoqëror dhe demografik.

Kjo qasje synon të krijojë kushte më të favorshme për familjet e reja dhe për pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.

Mbështetja për lehonat do të realizohet përmes **skemave të përbashkëta shtet-punëdhënëse**, me përkrahje buxhetore direkte, në mënyrë që lehonat të mos përbëjnë barrë për asnjërën palë.



2.5 Fondi i Papunësisë - Siguri në periudha tranzicioni

Humbja e vendit të punës është një nga situatat më të vështira për çdo familje. Për këtë arsye, Qeveria e PDK-së do ta krijojë **Fondin për Papunësinë**, si mekanizëm i qëndrueshëm mbrojtës për qytetarët që mbesin pa punë.

Fondi do të ofrojë mbështetje financiare të përkohshme, duke u lidhur njëkohësisht me programe të trajnimit, rikualifikimit dhe riintegritit në tregun e punës. Ky mekanizëm synon të reduktojë pasigurinë sociale dhe të ndihmojë qytetarët të kthehen më shpejt në punësim aktiv.

2.6 Mirëqenie sociale e qëndrueshme dhe e drejtë

Politikat e pagave, pensioneve dhe mirëqenies sociale do të ndërtohen mbi parimin e drejtësisë sociale dhe përgjegjësisë buxhetore. Qëllimi i Qeverisë së PDK-së është ndërtimi i një sistemi social që mbron më të dobëtit, shpërblen punën dhe garanton siguri për çdo qytetar.

Mirëqenia sociale nuk është kosto, por investim në stabilitet, kohezion shoqëror dhe zhvillim afatgjatë.



III. ENERGJIA

III. ENERGJIA

Siguri energjetike, diversifikim burimesh dhe kosto të përballueshme për qytetarët

Energjia është shtyllë strategjike e zhvillimit ekonomik, stabilitetit shoqëror dhe sigurisë kombëtare të Republikës së Kosovës. Furnizimi i qëndrueshëm, i sigurt dhe i përballueshëm me energji elektrike është parakusht për funksionimin e ekonomisë, për mirëqenien e familjeve dhe për besimin e qytetarëve në shtet.

Kosova ka përjetuar kriza të përsëritura energjetike, varësi të lartë nga importi dhe rritje të ndjeshme të çmimeve, të cilat kanë goditur drejtpërdrejt buxhetin familjar dhe konkurrueshmërinë e bizneseve. Këto sfida kërkojnë qasje të planifikuara, afatgjatë dhe të balancuar, që kombinon kapacitetet ekzistuese me burime të reja dhe alternativa të sigurta.

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do ta trajtojë sektorin e energjisë si **prioritet kombëtar**, me objektiv kryesor: **siguri në furnizim, ulje të koston për qytetarët dhe diversifikim të burimeve energjetike.**

3.1 Ulja e faturave të energjisë për qytetarët

Qeveria e PDK-së angazhohet për **heqjen e TVSH-së (0%) për energjinë elektrike**, si masë e drejtpërdrejtë për uljen e faturave mujore dhe për mbrojtjen e standardit jetësor të familjeve.

Energjia elektrike është nevojë bazike dhe jo luks.

Heqja e TVSH-së:

- ul menjëherë barrën financiare për qytetarët;
- rrit fuqinë blerëse mujore;
- kontribuon në stabilitet social.

3.2 Mbrojtja e konsumatorëve të ndjeshëm

Qeveria e PDK-së do të zbatojë mekanizma të posaçëm për mbrojtjen e konsumatorëve të ndjeshëm, përfshirë pensionistët, familjet me ndihma sociale dhe kategoritë e cënueshme.

Këta mekanizma do të përfshijnë:

- subvencionim të drejtpërdrejtë të konsumit bazë;
- tarifa mbrojtëse sociale;
- politika që parandalojnë shkyçjen nga energjia për arsye sociale.

Energjia do të trajtohet si shërbim esencial për jetë dinjitoze.

3.3 Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese - Termocentrali “Kosova e Re” (rreth 500 MW)

Siguria energjetike afatgjatë e Kosovës kërkon kapacitete të reja prodhuese vendore. PDK angazhohet për **ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re” me kapacitet rreth 500 MW.**

Ky projekt strategjik do të:

- sigurojë furnizim stabil për dekadat e ardhshme;
- zvogëlojë ndjeshëm varësinë nga importi;
- stabilizojë çmimin e energjisë;
- krijojë vende të reja pune dhe zhvillim ekonomik.

Ndërtimi do të realizohet me standarde të larta teknike dhe mjedisore, në përputhje me praktikat evropiane.

Vendimmarrja për këtë projekt do të bazohet në **analiza të detajuara të fizibilitetit ekonomik, financiar dhe mjedisor**, në përputhje me interesin publik dhe standardet evropiane.

3.4 Sigurimi i lëndës djegëse - Hapja e minierës së re të linjtit

Për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm të kapaciteteve ekzistuese dhe të reja, Qeveria e PDK-së do të realizojë **hapjen e minierës së re të linjtit**, sipas projekteve të verifikuara ndërkombëtare.

Kjo do të:

- sigurojë furnizim të qëndrueshëm për rreth 40 vjet;
- mbrojtë vendin nga krizat energjetike;
- ruajtë stabilitetin e prodhimit vendor.

3.5 Modernizimi i kapaciteteve ekzistuese - Revitalizimi i Termocentralit “Kosova B”

Termocentrali “Kosova B” do të revitalizohet dhe modernizohet për të zgjatur jetëgjatësinë e tij për së paku 25 vjet.

Modernizimi do të:

- rrisë sigurinë teknike;
- përmirësojë efikasitetin prodhues;
- ulë ndotjen përmes teknologjive më të avancuara;
- sigurojë prodhim stabil vendor.

3.6 Diversifikim burimesh dhe tranzicion energjetik

Qeveria e PDK-së angazhohet për avancimin e gazifikimit të Kosovës, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë dhe në përputhje me strategjitë rajonale dhe evropiane.

Gazifikimi do të:

- ofrojë alternativë më fleksibile dhe më të pastër për industri dhe ngrohje;
- ulë varësinë nga një burim i vetëm energjie;
- përmirësojë cilësinë e ajrit;
- rrisë sigurinë energjetike afatmesme dhe afatgjatë.

Zbatimi do të jetë i fazuar dhe i bazuar në analiza të fizibilitetit dhe interesit publik.

Zbatimi i gazifikimit do të nisë me **projekte pilot në zonat urbane dhe industriale**, duke u zgjeruar gradualisht në nivel kombëtar.

Zhvillimi i këtyre burimeve do të:

- realizohet gradualisht;
- mos rrezikojë sigurinë e furnizimit;
- mos krijojë kosto të papërbalueshme për qytetarët.

Qytetarët dhe bizneset do të inkurajohen të marrin pjesë në prodhimin e energjisë.

3.7 Efikasiteti energjetik - Kursim i energjisë dhe ulje e konsumit

Efikasiteti energjetik është mënyra më e shpejtë dhe më ekonomike për uljen e konsumit dhe faturave.


Qeveria e PDK-së do të zgjerojë:

- programet e izolimit termik të banesave;
- përmirësimin e efikasitetit në ndërtesat publike;
- zëvendësimin e pajisjeve joefikase.

3.8 Infrastrukturë energjetike dhe interkoneksione

PDK angazhohet për:

- forcimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes;
- zhvillimin e interkoneksioneve rajonale;
- veçanërisht lidhjen energjetike Kosovë–Shqipëri.



3.9 Ngrohje qendrore nga termocentralet në 5 qytete

Qeveria e PDK-së do të zhvillojë **sisteme të ngrohjes qendrore nga termocentralet ekzistuese në së paku pesë qytete të Kosovës**, si masë për rritjen e efikasitetit energjetik, uljen e ndotjes dhe zvogëlimin e shpenzimeve për ngrohje për familjet. Ky projekt do të shfrytëzojë energjinë termike të tepërt dhe do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së ajrit urban.

Këto projekte do të realizohen në bashkëpunim të ngushtë me komunat përfituese, duke siguruar zbatim të qëndrueshëm dhe efikas.

3.10 Park solar mbi hirin e termocentraleve

Qeveria e PDK-së do të realizojë **ndërtimin e një parku solar në zonën e hirit të termocentraleve**, duke e kthyer një hapësirë të degraduar mjedisore në burim të energjisë së pastër. Ky projekt përfaqëson tranzicion të mençur energjetik dhe përputhje me objektivat mjedisore evropiane.

Subvencione 30–50% për panelet solare, për familjet dhe bizneset. Kjo masë do të kontribuojë në përvetësim më të shpejtë të kësaj teknologjie, rritje të pavarësisë energjetike dhe ulje të faturave.

3.11 Qeverisja e sektorit të energjisë - Transparencë, stabilitet dhe interes publik

Sektori energjetik do të qeveriset me rregulla të qarta, transparente dhe të parashikueshme, duke mbrojtur interesin publik dhe konsumatorët.

3.12 Energjia si bazë e zhvillimit ekonomik dhe social

Energjia është bazë për zhvillim ekonomik, punësim dhe stabilitet social. Politikat energjetike të Qeverisë së PDK-së synojnë ta bëjnë energjinë **të sigurt, të përballueshme dhe të qëndrueshme për qytetarët dhe ekonominë**.



IV. MBROJTJA E AMBIENTIT

IV. MBROJTJA E AMBIENTIT

Mbrojtja e ambientit është çështje jetike për shëndetin publik, zhvillimin ekonomik dhe integrimin evropian të Kosovës. Ndotja e ajrit, degradimi i tokës, menaxhimi i dobët i mbetjeve, keqpërdorimi i burimeve natyrore dhe ndryshimet klimatike janë sfida reale që kërkojnë politika serioze dhe zbatim të vendosur të ligjit.

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do ta trajtojë ambientin si **prioritet shtetëror**, të lidhur drejtpërdrejt me energjinë, shëndetësinë, bujqësinë, planifikimin hapësinor dhe sigurinë ushqimore.

4.1 Ajër i pastër dhe mbrojtja e shëndetit publik

Qeveria e PDK-së do të zbatojë masa konkrete për uljen e ndotjes së ajrit, veçanërisht në qytetet me nivel të lartë ndotjeje.

Këto masa përfshijnë:

- zhvillimin e sistemeve të ngrohjes qendrore nga termocentralet në së paku pesë qytete;
- zëvendësimin gradual të ngrohjes individuale ndotëse;
- promovimin e efikasitetit energjetik në ndërtesa;
- monitorim të vazhdueshëm dhe transparent të cilësisë së ajrit.

Ajri i pastër është parakusht për shëndet publik dhe mirëqenie sociale.

4.2 Menaxhimi i mbetjeve dhe ekonomia qarkore

Qeveria e PDK-së do të reformojë rrënjësisht menaxhimin e mbetjeve përmes:

- ndarjes së mbetjeve në burim;
- zhvillimit të riciklimit dhe ripërdorimit;
- investimeve në impiante moderne për trajtimin e mbetjeve;
- dhe mbylljes së deponive ilegale.

Qëllimi është kalimi drejt **ekonomisë qarkore**, në përputhje me standardet e BE-së.



4.3 Rehabilitimi mjedisor dhe energjia e pastër

Qeveria e PDK-së do të zbatojë projekte konkrete për rehabilitimin mjedisor, duke përfshirë:

- ndërtimin e parkut solar në zonën e hirit të termocentraleve;
- rehabilitimin e tokave të degraduara nga aktiviteti industrial dhe minerar;
- dhe integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

4.4 Mbrojtja e ujërave - Uji si pasuri kombëtare

Qeveria e PDK-së do të forcojë mbrojtjen e burimeve ujore përmes:

- kontrollit të ndotjes industriale dhe urbane;
- investimeve në impiante për trajtimin e ujërave të zeza;
- mbrojtjes së lumenjve, liqeneve dhe burimeve të pijes;
- dhe menaxhimit të qëndrueshëm të baseneve ujore.

Uji është burim jetik dhe duhet mbrojtur si pasuri strategjike kombëtare.

4.5 Pyjet, toka dhe biodiversiteti - Ndalesë degradimit dhe shkatërrimit

Qeveria e PDK-së do të ndërmarrë masa të vendosura për:

- ndalimin e prerjeve ilegale të pyjeve;
- rehabilitimin e tokave të degraduara;
- mbrojtjen e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura;
- dhe rritjen e hapësirave të gjelbra urbane.

Mbrojtja e pyjeve dhe tokës është e lidhur drejtpërdrejt me sigurinë ushqimore dhe klimatike.

4.6 Ndryshimet klimatike dhe përshtatja me politika të përgjegjshme

Qeveria e PDK-së do të integrojë politikat klimatike në zhvillimin ekonomik, duke:

- ulur emetimet e gazrave serrë;
- rritur reziliencën ndaj fatkeqësive natyrore;
- dhe harmonizuar politikat me Marrëveshjen e Parisit dhe acquis të BE-së.

4.7 Zbatimi i ligjit dhe inspektimet mjedisore - Ligje që zbatohen, jo vetëm që shkruhen

Qeveria e PDK-së do të:

- forcojë inspektoratet mjedisore;
- rrisë përgjegjësinë institucionale;
- përmirësojë ndëshkimin e shkeljeve mjedisore;
- dhe garantojë transparencë në vendimmarrjen mjedisore.

Inspektimet mjedisore do të përforcohen përmes **përdorimit të teknologjisë digjitale dhe qasjes së bazuar në risk**, për të rritur efektivitetin dhe transparencën.

4.8 Ambienti dhe integrimi evropian

Mbrojtja e ambientit është kriter kyç për integrimin evropian të Kosovës. Politikat mjedisore të Qeverisë së PDK-së do të synojnë përmbushjen e standardeve të BE-së dhe krijimin e një mjedisi të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm.





V. DREJTËSIA

#PDK130

V. DREJTËSIA

Pavarësi e gjyqësorit, drejtësi efikase dhe besim publik në institucione

Sundimi i ligjit është themeli i shtetit demokratik dhe kushti kryesor për stabilitet politik, zhvillim ekonomik dhe integrim euroatlantik. Një sistem drejtësie i pavarur, profesional dhe efikas garanton barazi para ligjit, mbron të drejtat e qytetarëve dhe krijon besim në institucionet publike.

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës e konsideron **pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit si vlera të panegociueshme**. Roli i Qeverisë nuk është të ndërhyjë në vendimmarrjen gjyqësore, por të krijojë kushtet institucionale, financiare dhe ligjore që gjyqësori të ushtrojë funksionin e vet në mënyrë të pavarur, efikase dhe profesionale.

5.1 Pavarësia dhe integriteti i gjyqësorit - Respekt i plotë për ndarjen e pushteteve

Qeveria e PDK-së do të përkrahë fuqishëm **pavarësinë funksionale dhe institucionale të gjyqësorit**, duke respektuar në mënyrë rigorozë parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve.

Kjo përfshin:

- mosndërhyrje në vendimmarrjen gjyqësore;
- respektim të autonomisë së institucioneve të drejtësisë;
- dhe mbrojtje të integritetit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Një gjyqësor i pavarur është garanci për drejtësi të barabartë dhe shtet funksional.

5.2 Përkrahja institucionale për forcimin e drejtësisë - Kapacitete, kushte dhe profesionalizëm

Qeveria e PDK-së do të përkrahë gjyqësorin përmes:

- sigurimit të buxhetit të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm;
- përmirësimit të kushteve të punës në gjykata dhe prokurori;

- investimeve në infrastrukturë dhe teknologji;
- dhe mbështetjes për ngritjen profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Kjo përkrahje synon rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së punës së sistemit të drejtësisë, pa cenuar pavarësinë e tij.

5.3 Zvogëlimi i lëndëve të grumbulluara (backlog) - Drejtësi më e shpejtë për qytetarët

Një nga sfidat më të mëdha të sistemit të drejtësisë është numri i lartë i lëndëve të pazgjidhura. Qeveria e PDK-së do të mbështesë projektet e gjyqësorit për **zvogëlimin e backlog-ut**, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e drejtësisë.

Kjo përkrahje do të përfshijë:

- financim për projekte të posaçme për trajtimin e lëndëve të vjetra;
- rritje të kapaciteteve administrative dhe profesionale;
- digjitalizim të proceseve gjyqësore;
- dhe përmirësim të menaxhimit të lëndëve.

Këto masa do të zbatohen **në koordinim të plotë me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial**, duke respektuar pavarësinë dhe integritetin e gjyqësorit.

Qytetarët kanë të drejtë në drejtësi në kohë të arsyeshme.

5.4 Gjykata e Punës - Qasje e shpejtë dhe e specializuar në drejtësi për punëtorët

Qeveria e PDK-së do të mbështesë krijimin e **Gjykatës së Punës**, si institucion i specializuar për trajtimin e kontesteve të punës në sektorin publik dhe privat.



Gjykata e Punës synon:

- trajtim të shpejtë dhe profesional të rasteve të punës;
- uljen e ngarkesës në gjykatat e rregullta;
- forcimin e sigurisë juridike në marrëdhëniet e punës.

Krijimi i kësaj gjykate do të bëhet në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe parimet e pavarësisë së gjyqësorit.

5.5 Digjitalizimi i drejtësisë - Transparencë dhe efikasitet

Qeveria e PDK-së do të përkrahë digjitalizimin e sistemit të drejtësisë për të rritur transparencën, efikasitetin dhe qasjen e qytetarëve në shërbime gjyqësore.

Digjitalizimi do të kontribuojë në:

- përsheptimin e procedurave;
- reduktimin e vonesave administrative;
- përmirësimin e menaxhimit të lëndëve.

5.6 Qasja në drejtësi dhe ndihma juridike - Drejtësi e arritshme për të gjithë

Qeveria e PDK-së do të vazhdojë përkrahjen për **ndihmën juridike falas**, në mënyrë që drejtësia të jetë e qasshme për të gjithë qytetarët, pavarësisht gjendjes ekonomike.

5.7 Zbatimi i vendimeve gjyqësore - Drejtësi që zbatohet në praktikë

Vendimet gjyqësore duhet të zbatohen në mënyrë efektive. Qeveria e PDK-së do të përkrahë mekanizmat institucionalë që sigurojnë zbatim të plotë dhe në kohë të vendimeve gjyqësore.

5.8 Drejtësia si bazë e shtetit funksional

Një sistem drejtësie i pavarur, i fortë dhe efikas është themeli i shtetit ligjor dhe parakusht për besim publik, investime dhe integrim evropian.





VI. SHËNDETËSIA

#PDK130

VI. SHËNDETËSIA

Shëndetësia është një nga shtyllat kryesore të mirëqenies shoqërore dhe një prej përgjegjësiw më të rëndësishme të shtetit. Një sistem shëndetësor funksional nuk matet vetëm me ekzistencën e institucioneve, por me cilësinë e shërbimeve, qasjen e barabartë për qytetarët dhe sigurinë që shteti u ofron familjeve në momentet më të vështira.

Në Kosovë, qytetarët përballen me lista të gjata pritjeje, mungesë të barnave, shpenzime të larta nga xhepi dhe pasiguri në raste të sëmundjeve serioze. Këto probleme kërkojnë reforma të thella dhe një qasje të re, që e vendos pacientin në qendër të sistemit shëndetësor.

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do të ndërtojë një **sistem shëndetësor publik të qëndrueshëm, efikas dhe të drejtë**, që garanton shërbime cilësore për çdo qytetar, pa dallim.

6.1 Zbatimi i plotë i sigurimeve shëndetësore - Mbrojtje financiare për qytetarët dhe familjet

Zbatimi i sistemit të **sigurimeve shëndetësore** është prioritet strategjik. Ky sistem do të krijojë bazë të qëndrueshme financiare për shëndetësinë publike dhe do t'i mbrojë qytetarët nga shpenzimet e papërballueshme shëndetësore.

Sigurimet shëndetësore do të:

- mbulojnë shërbimet bazë dhe specialistike;
- reduktojnë pagesat direkte nga xhepi i qytetarëve;
- rrisin transparencën dhe efikasitetin e financimit;
- lidhin financimin me cilësinë e shërbimit.

6.2 Lista esenciale e barnave dhe furnizimi i rregullt - Barna të sigurta dhe të qasshme

Qeveria e PDK-së do të garantojë furnizim të rregullt dhe të qëndrueshëm me barna esenciale në të gjitha institucionet publike shëndetësore.

Lista e barnave esenciale do të:

- rishikohet dhe zgjerohet;
- përditësohet sipas standardeve bashkëkohore;
- menaxhohet me transparencë të plotë në prokurim.

Asnjë pacient nuk duhet të detyrohet të blejë barna esenciale vetë për shkak të mungesës në sistemin publik.

Qeveria e PDK-së do të sigurojë **barna falas për pacientët me sëmundje kronike**, përmes listës esenciale të barnave dhe sistemit publik shëndetësor. Kjo masë synon të ulë shpenzimet direkte të familjeve, të përmirësojë vazhdimësinë e trajtimit mjekësor dhe të garantojë kujdes dinjitoz për pacientët kronikë.

6.3 Modernizimi i infrastrukturës shëndetësore - Spitale funksionale dhe shërbime moderne

Qeveria e PDK-së do të investojë në modernizimin e spitaleve ekzistuese dhe ndërtimin e infrastrukturës së re shëndetësore.

Kjo përfshin:

- përmirësimin e kushteve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës;
- modernizimin e spitaleve rajonale;
- ndërtimin e **Spitalit Rajonal të Prishtinës**.

Qëllimi është që shërbimet shëndetësore cilësore të ofrohen brenda vendit, pa pasur nevojë për trajtim jashtë Kosovës.

6.4 Themelimi i Qendrës Kombëtare të Urgjencës Mjekësore (QKUM)

Qeveria e PDK-së do të themelojë **Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore**, me sistem unik kombëtar të dispeçerimit dhe koordinimit të shërbimeve emergjente. QKUM do të përmirësojë reagimin në kohë reale, koordinimin ndërinstitutional dhe shpëtimin e jetës së qytetarëve në raste emergjente.

QKUM do të funksionojë **në bashkëpunim me shërbimet ekzistuese emergjente**, me sistem unik të koordinimit dhe reagimit të shpejtë.

6.5 Pajisje mjekësore dhe teknologji bashkëkohore - Diagnostikim i saktë dhe trajtim në kohë

PDK do të investojë në pajisje moderne diagnostikuese dhe terapeutike, përfshirë:

- aparatura për diagnostikim të avancuar;
- pajisje laboratorike moderne;
- teknologji për trajtim specialistik.

Këto investime do të reduktojnë listat e pritjes dhe do të përmirësojnë cilësinë e trajtimit.

6.6 Digjitalizimi i shëndetësisë - Sistem modern dhe transparent

Shëndetësia do të digjitalizohet për të rritur efikasitetin dhe transparencën.

Do të zhvillohet një platformë kombëtare digjitale që do të:

- lidhë pacientët me institucionet shëndetësore;
- digjitalizojë kartelat mjekësore;
- menaxhojë listat e pritjes;
- rrisë llogaridhënien institucionale.

6.7 Fuqizimi i stafit shëndetësor - Mjekë dhe infermierë të vlerësuar dhe të motivuar

Stafi shëndetësor është pasuria më e madhe e sistemit shëndetësor.

Qeveria e PDK-së do të:

- përmirësojë kushtet e punës;
- ofrojë trajnime të vazhdueshme profesionale;
- mbështesë specializimet deficitare;
- krijojë politika për ruajtjen e profesionistëve brenda vendit.

6.8 Kujdesi për nënën dhe fëmijën - Shëndet i sigurt që nga lindja

Shëndeti i nënës dhe fëmijës është prioritet shtetëror.

PDK do të:

- forcojë shërbimet obstetrike dhe neonatale;
- përmirësojë kushtet në maternitetet publike;
- sigurojë kujdes të specializuar për foshnjat dhe nënat.

6.9 Shëndeti mendor - Kujdes i barabartë dhe dinjitoz

Shëndeti mendor do të trajtohet si pjesë integrale e shëndetit publik.

Qeveria e PDK-së do të:

- zgjerojë shërbimet psikosociale;
- krijojë qendra komunitare për shëndet mendor;
- integrojnë shërbimet e shëndetit mendor në kujdesin parësor.

6.10 Kujdesi për sëmundjet kronike dhe të moshuarit - Trajtim afatgjatë dhe dinjitet

Do të krijohen programe të posaçme për:

- pacientët me sëmundje kronike;
- të moshuarit;
- personat me nevoja afatgjata shëndetësore.

Qëllimi është trajtim i vazhdueshëm, dinjitoz dhe i koordinuar.

6.11 Kujdesi paliativ dhe rehabilitimi - Dinjitet në çdo fazë të jetës

PDK do të zhvillojë shërbime të kujdesit paliativ dhe rehabilitimit, për të garantuar mbështetje për pacientët me sëmundje të rënda dhe familjet e tyre.

6.12 Zhvillimi i shërbimit të mjekësisë mobile

Qeveria e PDK-së do të zhvillojë **shërbimin e mjekësisë mobile**, duke sjellë shërbime shëndetësore bazike dhe specialistike drejtpërdrejt te qytetarët në zonat rurale dhe të largëta. Ky shërbim synon rritjen e qasjes në kujdes shëndetësor dhe barazinë territoriale në shëndetësi.

6.13 Themelimi i Qendrës Kombëtare për Trajtimin e Varësive

Qeveria e PDK-së do të themelojë **Qendrën Kombëtare për Trajtimin e Varësive**, për trajtimin e varësisë nga substancat, alkooli, etj. Kjo qendër do të ofrojë trajtim multidisiplinar, rehabilitim dhe mbështetje sociale për pacientët dhe familjet e tyre.

6.14 Programi Kombëtar për Parandalimin dhe Trajtimin e Kancerit

Qeveria e PDK-së do të zbatojë **Programin Kombëtar për Kancerin**, duke përfshirë skring të organizuar, diagnostikim të hershëm dhe trajtim sipas standardeve evropiane. Programi synon uljen e vdekshmërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve.

Programi do të mbështetet nga **linja të dedikuara buxhetore**, për të garantuar zbatim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

6.15 Zhvillimi i qendrave rajonale të rehabilitimit

Qeveria e PDK-së do të zhvillojë **qendra rajonale të rehabilitimit neurologjik, kardiak dhe fizik**, për të siguruar trajtim afatgjatë dhe cilësor për pacientët pas sëmundjeve dhe ndërhyrjeve të rënda shëndetësore.

6.16 Prodhimi vendor farmaceutik - Siguri dhe pavarësi në furnizim

Qeveria e PDK-së do të mbështesë zhvillimin e prodhimit vendor farmaceutik, për të:

- ulur varësinë nga importi;
- siguruar furnizim të qëndrueshëm me barna;
- krijuar vende të reja pune.

6.17 Shëndetësia si investim strategjik

Shëndetësia nuk është kosto, por investim në mirëqenie, produktivitet dhe stabilitet shoqëror. Një sistem shëndetësor i fortë është themel i një shoqërie të shëndetshme dhe ekonomie funksionale.



VII. ARSIMI

VII. ARSIMI

Arsimi është themeli i zhvillimit afatgjatë të Kosovës dhe investimi më i rëndësishëm në kapitalin njerëzor. Një sistem arsimor cilësor përcakton aftësinë e një shoqërie për të konkurruar, për të inovuar dhe për të ndërtuar institucione të qëndrueshme. Pa arsim funksional dhe gjithëpërfshirës, nuk mund të ketë zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Sistemi arsimor në Kosovë përballet me sfida serioze: cilësi të pabarabartë, infrastrukturë të pamjaftueshme, mospërputhje me tregun e punës dhe mungesë të mbështetjes për mësimdhënësit dhe nxënësit. Këto sfida kërkojnë reformë të thellë dhe vizion afatgjatë.

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do të ndërtojë një sistem arsimor **modern, cilësor dhe të drejtë**, që u ofron të gjithë nxënësve dhe studentëve mundësi të barabarta për zhvillim dhe sukses.

7.1 Arsimi parashkollor dhe edukimi i hershëm - Fillim i barabartë për çdo fëmijë

PDK angazhohet për zgjerimin e qasjes në **arsim parashkollor cilësor**, duke investuar në ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve të reja, veçanërisht në zonat me mungesë shërbimesh.

Edukimi i hershëm do të:

- rrisë barazinë në fillim të shkollimit;
- përmirësojë zhvillimin kognitiv dhe social të fëmijëve;
- mbështesë prindërit, veçanërisht nënat, në tregun e punës.

7.2 Arsimi fillor dhe i mesëm - Cilësi, dije funksionale dhe barazi

Reforma në arsimin fillor dhe të mesëm do të fokusohet në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përvetësimit të njohurive funksionale.

Qeveria e PDK-së do të:

- rishikojë kurrikulat për t'i përshtatur me nevojat bashkëkohore;
- përmirësojë tekstet shkollore;
- forcojë vlerësimin e nxënësve;
- garantojë kushte të barabarta mësimi në të gjitha shkollat.

7.3 Mësimdhënës të fuqizuar dhe të vlerësuar - Cilësia e arsimit fillon me mësuesin

Mësimdhënësit janë shtylla e sistemit arsimor. Qeveria e PDK-së do të investojë në zhvillimin profesional të tyre përmes:

- trajnimeve të vazhdueshme;
- avancimit meritokratik;
- përmirësimit të kushteve të punës.

Vlerësimi i mësimdhënësve do të bazohet në cilësi dhe përkushtim, jo në improvizime administrative.

7.4 Infrastrukturë shkollore moderne - Shkolla të sigurt dhe funksionale

PDK do të investojë në ndërtimin dhe renovimin e objekteve shkollore, për të garantuar:

- mjedise të sigurt për nxënësit;
- kushte dinjitoze për mësimdhënie;
- pajisje bashkëkohore mësimore.

Asnjë nxënës nuk duhet të mësojë në kushte të papërshtatshme.

7.5 Psikolog dhe zyrtar sigurie në çdo shkollë

Qeveria e PDK-së do të sigurojë **psikolog dhe zyrtar sigurie në çdo shkollë**, si standard kombëtar për mbrojtjen e shëndetit mendor të nxënësve, parandalimin e dhunës dhe krijimin e mjedisit të sigurt arsimor.

Zbatimi do të bëhet **në bashkëpunim me komunat dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme**, për të garantuar mjedis të sigurt dhe mbështetje profesionale për nxënësit.

7.6 Digjitalizimi i arsimit - Teknologjia në shërbim të dije

Arsimi do të digjitalizohet për të rritur cilësinë dhe qasjen në dije.

Kjo përfshin:

- pajisje digjitale për nxënësit dhe mësime dhënësit;
- platforma digjitale mësimore;
- zhvillimin e aftësive digjitale që nga mosha e hershme.

7.7 Arsimi profesional dhe lidhja me tregun e punës - Aftësi për punësim dhe zhvillim ekonomik

PDK angazhohet për forcimin e **arsimit profesional**, duke e lidhur drejtpërdrejt me nevojat e tregut të punës.

Do të:

- modernizohen shkollat profesionale;
- përfshihen bizneset në procesin e edukimit praktik;
- krijohen programe që çojnë drejtpërdrejt në punësim.

7.8 Arsimi i lartë - Universitete konkurruese me kërkime shkencore

Qeveria e PDK-së do të:

- forcojë autonominë universitare;
- rrisë cilësinë e mësime dhënësit;
- mbështesë kërkimin shkencor dhe inovacionin;
- rrisë bashkëpunimin ndërkombëtar.

7.9 Bursa dhe mbështetje për studentët - Fondi i Bursave

Qeveria e PDK-së do të krijojë **Fondin e Bursave për Studentë**, me vlerë **30 milionë euro në vit**, për mbështetjen e studentëve. Ky fond synon të

garantojë qasje në arsim të lartë dhe të investojë direkt në kapitalin njerëzor të Kosovës.

7.10 Arsimi gjithëpërfshirës - Askush jashtë sistemit arsimor

Arsimi do të jetë gjithëpërfshirës për:

- fëmijët me nevoja të veçanta;
- komunitetet pakicë;
- nxënësit nga zonat rurale.

Barazia në arsim është parakusht për barazi shoqërore.

7.11 Arsimi si investim strategjik kombëtar

Arsimi nuk është shpenzim, por investim në të ardhmen e Kosovës. Një sistem arsimor i fortë ndërton qytetarë të aftë, ekonomi konkurruese dhe shtet të qëndrueshëm.



VIII. KULTURA, RINIA DHE SPORTI

VIII. KULTURA, RINIA DHE SPORTI

Identitet kombëtar, energji rinore dhe investim në shoqëri të shëndetshme

Kultura, rinia dhe sporti janë shtylla të rëndësishme të zhvillimit shoqëror, identitetit kombëtar dhe kohezionit social. Një shtet që investon në këto fusha ndërton qytetarë aktivë, krijues dhe të lidhur me vendin e tyre. Këto politika nuk janë luks i një shoqërie të pasur, por **kusht për zhvillim të qëndrueshëm dhe stabilitet afatgjatë.**

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do t'i trajtojë kulturën, rininë dhe sportin si **politika publike me ndikim të drejtpërdrejtë ekonomik, social dhe diplomatik**, duke krijuar kushte për shprehje krijuese, përfshirje rinore dhe jetë aktive.



8.1 Kultura si vlerë dhe identitet kombëtar - Mbështetje për krijimtarinë dhe trashëgiminë kulturore

Qeveria e PDK-së do të forcojë politikat për mbështetjen e kulturës dhe artit, duke e trajtuar kulturën si pjesë të identitetit kombëtar dhe prezantimit ndërkombëtar të Kosovës.

Kjo përfshin:

- mbështetje për artistët dhe institucionet kulturore;
- financim transparent dhe konkurrues për projekte kulturore;
- ruajtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore;
- zhvillim të diplomacisë kulturore si mjet afirmimi ndërkombëtar.

Kultura do të mbështetet si sektor krijues dhe si pjesë e ekonomisë kulturore.

8.2 Rinia si prioritet kombëtar - Mundësi, pjesëmarrje dhe perspektivë

Rinia është potenciali më i madh i Kosovës. Politikat rinore të Qeverisë së PDK-së do të fokusohen në krijimin e mundësive reale për zhvillim personal, profesional dhe shoqëror.

Masat do të përfshijnë:

- programe për fuqizimin e të rinjve;
- mbështetje për iniciativa rinore dhe organizata të të rinjve;
- hapësira publike për aktivitete rinore;
- përfshirje të të rinjve në vendimarrje.

Qëllimi është që të rinjtë të shohin të ardhmen e tyre në Kosovë, jo jashtë saj.

8.3 Arsimi joformal dhe kreativiteti - Zhvillim përtej klasës

Qeveria e PDK-së do të mbështesë arsimin joformal, aktivitetet kulturore, kreative dhe inovative, si pjesë e zhvillimit gjithëpërfshirës të të rinjve.

Kjo përfshin:

- programe artistike, kulturore dhe kreative;
- mbështetje për inovacion dhe ide të reja;
- bashkëpunim me sektorin civil dhe privat.

8.4 Sporti si investim në shëndet dhe përfaqësim shtetëror - Mbështetje për sportistët dhe federatat sportive

Sporti është faktor i rëndësishëm për shëndetin publik, disiplinën shoqërore dhe përfaqësimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Qeveria e PDK-së do të:

- rrisë mbështetjen për federatat sportive;
- mbështesë sportistët profesionistë dhe amatorë;
- investojë në programe sportive për fëmijë dhe të rinj.

Sporti do të trajtohet si politikë publike dhe jo si aktivitet marginal.

8.5 Infrastruktura sportive - Kushte dinjitoze për sport dhe aktivitete rinore

Qeveria e PDK-së do të investojë në ndërtimin dhe modernizimin e infrastrukturës sportive në të gjithë vendin.

Kjo përfshin:

- palestra sportive;
- fusha sportive lokale;
- qendra multifunksionale për të rinjtë;
- projekte të mëdha kombëtare.

8.6 Ndërtimi i Stadiumit Olimpik Kombëtar

Qeveria e PDK-së do të realizojë **ndërtimin e Stadiumit Olimpik Kombëtar**, si projekt strategjik për zhvillimin e sportit, organizimin e garave ndërkombëtare dhe promovimin e Kosovës.

Ky projekt do të:

- krijojë kushte për ngjarje sportive ndërkombëtare;
- rrisë turizmin sportiv;
- kontribuojë në zhvillimin ekonomik;
- forcojë identitetin shtetëror.

8.7 Kultura, rinia dhe sporti si faktor zhvillimi shoqëror

Investimi në kulturë, rini dhe sport është investim në shoqëri të shëndetshme, aktive dhe të bashkuara. Qeveria e PDK-së synon të krijojë politika që fuqizojnë qytetarët, nxisin krijimtarinë dhe forcojnë lidhjen e shoqërisë me shtetin.



IX. SIGURIA

IX. SIGURIA

Siguria është një nga funksionet themelore të shtetit dhe kusht i domosdoshëm për stabilitet politik, zhvillim ekonomik dhe jetë të qetë për qytetarët. Një shtet i sigurt garanton rend publik, mbron jetën dhe pronën e qytetarëve dhe është i përgatitur për të përballuar krizat, emergjencat dhe kërcënimet e ndryshme.

Kosova përballlet me sfida të shumta në fushën e sigurisë: nevojë për forcim të kapaciteteve të Policisë, reagim më të shpejtë ndaj emergjencave, mbrojtje më të mirë dhe koordinim më efikas ndërinstitutional.

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do të ndërtojë një **sistem sigurie modern, profesional dhe gjithëpërfshirës**, që garanton rend, mbrojtje dhe reagim të shpejtë në çdo situatë.

9.1 Forcimi i Policisë së Kosovës - Siguri publike dhe rend ligjor

Policia e Kosovës është shtylla kryesore e rendit publik dhe sigurisë së përditshme të qytetarëve. Qeveria e PDK-së do të investojë në forcimin e kapaciteteve të Policisë përmes:

- përmirësimit të kushteve të punës dhe pajisjeve;
- trajnimeve profesionale të vazhdueshme;
- modernizimit të mjeteve operative.

Qëllimi është një polici profesionale, e pranishme dhe e besueshme për qytetarët.

9.2 Reagimi ndaj emergjencave - Gatishmëri dhe koordinim institucional

Reagimi i shpejtë dhe i koordinuar ndaj emergjencave është jetik për mbrojtjen e jetës dhe pronës.

Qeveria e PDK-së do të:

- forcojë kapacitetet e emergjencave civile;
- përmirësojë koordinimin ndërmjet Policisë, zjarrfikësve, shërbimeve shëndetësore dhe institucioneve të tjera;
- modernizojë sistemet e komunikimit emergjent.



9.3 Krijimi i Njesisë së Helikopterëve - Reagim i shpejtë dhe mbulim kombëtar

Qeveria e PDK-së do të krijojë **Njësinë e Helikopterëve**, si kapacitet strategjik për sigurinë kombëtare dhe reagimin ndaj emergjencave.

Kjo njësi do të përdoret për:

- operacione kërkim-shpëtimi;
- reagim në fatkeqësi natyrore;
- transport emergjent mjekësor;
- mbështetje për Policinë dhe institucionet e sigurisë;
- operacione në terrene të vështira.

Krijimi i kësaj njësie rrit ndjeshëm kapacitetin e shtetit për reagim të shpejtë dhe efikas.

9.4 Themelimi i Gardës Kombëtare të Kosovës - Kapacitet shtesë për siguri, mbrojtje civile dhe reagim në kriza

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për **themelimin e Gardës Kombëtare të Kosovës**, si strukturë shtesë dhe mbështetëse e sistemit të sigurisë kombëtare, në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe standardet euroatlantike.

Garda Kombëtare do të ketë rol **mbrojtës, civil e reagues** dhe **nuk do të zëvendësojë** as Policinë e Kosovës dhe as Forcën e Sigurisë së Kosovës, por do të funksionojë si **kapacitet plotësues**, veçanërisht në situata emergjente dhe kriza të jashtëzakonshme.

Roli i Gardës Kombëtare do të përfshijë:

- reagimin në raste të fatkeqësive natyrore, si përmytje, tërmete dhe zjarre;
- mbështetjen e mbrojtjes civile dhe shërbimeve emergjente;
- asistimin e institucioneve të sigurisë në raste krizash të mëdha;
- kontributin në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, kur kjo kërkohet nga autoritetet kompetente.

Themelimi i Gardës Kombëtare do të:

- rrisë kapacitetin shtetëror për reagim të shpejtë dhe të koordinuar;
- përmirësojë gatishmërinë kombëtare ndaj krizave;
- forcojë ndjenjën e sigurisë dhe mbrojtjes së qytetarëve.

Kjo strukturë do të ndërtohet mbi këto parime:

- profesionalizëm,
- trajnim të specializuar,
- koordinim të plotë ndër-institucional,
- respektim të plotë të rendit kushtetues dhe sundimit të ligjit.

Garda Kombëtare do të zhvillohet gradualisht, me planifikim të kujdesshëm dhe në koordinim me partnerët ndërkombëtarë, duke u integruar në arkitekturën e përgjithshme të sigurisë së Republikës së Kosovës.

9.5 Mbrojtja civile dhe menaxhimi i krizave - Shtet i përgatitur për situata të jashtëzakonshme

Qeveria e PDK-së do të forcojë sistemin e mbrojtjes civile përmes:

- planeve të qarta për menaxhimin e krizave;
- trajnimeve për institucionet dhe komunitetet lokale;
- investimeve në pajisje dhe infrastrukturë emergjente.

Qëllimi është minimizimi i dëmeve dhe mbrojtja e jetës në raste të fatkeqësive natyrore apo krizave të tjera.

9.6 Siguria kufitare - Mbrojtje e territorit dhe rend ligjor

Siguria kufitare është komponent kyç i sigurisë kombëtare. PDK angazhohet për:

- modernizimin e pajisjeve dhe teknologjisë kufitare;
- trajnime të avancuara për stafin;
- bashkëpunim të ngushtë ndërkombëtar për luftimin e krimit ndërkufitar.

9.7 Lufta kundër krimit të organizuar dhe ekstremizmit - Siguri për shoqërinë dhe sundim i ligjit

Qeveria e PDK-së do të vazhdojë luftën e vendosur kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe ekstremizmit përmes:

- forcimit të kapaciteteve hetimore;
- bashkëpunimit ndërkombëtar;
- zbatimit rigoroz të ligjit.

9.8 Siguria në komunitet - Parandalim dhe bashkëpunim me qytetarët

Siguria fillon në komunitet. PDK do të forcojë modelet e policimit në komunitet për të:

- rritur besimin ndërmjet Policisë dhe qytetarëve;
- parandaluar kriminalitetin;
- përmirësuar sigurinë lokale.

9.9 Forcimi i sigurisë kibernetike kombëtare

Qeveria e PDK-së do të zhvillojë kapacitete shtetërore **për sigurinë kibernetike**, për mbrojtjen e institucioneve publike, infrastrukturës kritike dhe të dhënave të qytetarëve nga kërcënimet digjitale dhe hibride.

9.10 Siguria si parakusht për zhvillim dhe stabilitet

Siguria është bazë për zhvillim ekonomik, investime dhe jetë të qetë. Politikat e Qeverisë së PDK-së synojnë ndërtimin e një ambienti të sigurt ku qytetarët ndihen të mbrojtur dhe të lirë.





X. POLITIKA E JASHTME

#PDK130

X. POLITIKA E JASHTME

Politika e jashtme e Republikës së Kosovës duhet të jetë instrument i stabilitetit, zhvillimit dhe sigurisë kombëtare. Një shtet i vogël, por me ambicie të qarta euroatlantike, ka nevojë për një politikë të jashtme të matur, të parashikueshme dhe të koordinuar ngushtë me aleatët strategjikë.

Në vitet e fundit, Kosova ka humbur besueshmëri ndërkombëtare për shkak të qasjeve të paqëndrueshme, mungesës së koordinimit me partnerët dhe improvizimeve në politikën e jashtme. Kjo ka rezultuar në izolim relativ, tensione të panevojshme dhe dobësim të pozitës ndërkombëtare të vendit.

Qeveria e udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës do ta rikthejë **politikën e jashtme si politikë shtetërore**, jo partiake, duke ndërtuar marrëdhënie të qëndrueshme, besim të ndërsjellë dhe partneritet afatgjatë me aleatët tanë kryesorë.

10.1 Integrimi evropian

Proces reformues dhe angazhim serioz shtetëror

Integrimi në Bashkimin Evropian mbetet objektivi strategjik dhe shumë i qartë i Republikës së Kosovës. Qeveria e PDK-së do ta trajtojë procesin e integrimit evropian si projekt gjithëpërfshirës shtetëror, duke e lidhur drejtpërdrejt me reformat e brendshme dhe sundimin e ligjit.

Angazhimi për integrim evropian do të përfshijë:

- zbatim të plotë dhe të qëndrueshëm të reformave në drejtësi, administratë dhe ekonomi;
- përmbushje të obligimeve që dalin nga proceset integruese;
- dialog të vazhdueshëm politik me institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare.

Kosova do të pozicionohet si partner serioz dhe konstruktiv në procesin evropian.

10.2 Partneriteti strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Partneriteti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës është themeli i shtetësisë, sigurisë dhe zhvillimit demokratik të Kosovës. Ky partneritet nuk është vetëm historik, por edhe strategjik për të ardhmen.

Qeveria e PDK-së do të punojë për:

- rikthimin e koordinimit të plotë politik dhe diplomatik me SHBA-në;
- forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes;
- zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe institucional.

Qeveria e PDK-së do të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të rinisur **Dialogun Strategjik me SHBA-në**, si platformë e rregullt për bashkëpunim në siguri, ekonomi, energji dhe demokraci, duke e forcuar partneritetin strategjik afatgjatë.

Kosova do të veprojë gjithmonë në harmoni me interesat strategjike të SHBA-së dhe vlerat euroatlantike.

10.3 Integrimi në NATO - Siguri afatgjatë dhe stabilitet rajonal

Anëtarësimi në NATO është objektivi strategjik për sigurinë kombëtare të Kosovës. Qeveria e PDK-së do të intensifikojë përpjekjet për avancimin e Kosovës drejt strukturave euroatlantike të sigurisë. Kjo do të përfshijë:

- forcimin e kapaciteteve të sigurisë dhe mbrojtjes;
- rritjen e interoperabilitetit me vendet anëtare të NATO-s;
- përmbushjen e standardeve politike dhe ushtarake të Aleancës.

Kosova do të vazhdojë të kontribuojë në stabilitetin rajonal si faktor i paqes.

Qeveria e PDK-së do të punojë për **anëtarësimin e Kosovës në Partneritetin për Paqe**, si hap i rëndësishëm drejt integritetit të plotë në NATO dhe forcimit të sigurisë kombëtare.

10.4 Marrëdhëniet rajonale - Stabilitet, bashkëpunim dhe fqinjësi e mirë

Qeveria e PDK-së do të zhvillojë marrëdhënie të mira fqinjësore, të bazuara në respekt të ndërsjellë, sovranitet dhe integritet territorial.

Bashkëpunimi rajonal do të shërbejë për:

- ndërtimin e stabilitetit afatgjatë;
- zhvillimin ekonomik dhe ndërlidhjen infrastrukturor;
- avancimin e proceseve integruese evropiane.

Kosova do të jetë aktor konstruktiv në rajon.

10.5 Dialogu Kosovë-Serbi - Proces i koordinuar, i drejtë dhe i qëndrueshëm

Dialogu me Serbinë është proces kompleks që kërkon maturi, unitet të brendshëm dhe koordinim të plotë me aleatët strategjikë.

Qeveria e PDK-së do të:

- zhvillojë dialogun në koordinim të ngushtë me SHBA-në dhe BE-në;
- mbrojë sovranitetin dhe rendin kushtetues të Kosovës;
- synojë marrëveshje të qëndrueshme dhe të zbatueshme ndërkombëtarisht.

Asnjë proces dialogu nuk do të zhvillohet në dëm të interesit shtetëror.

10.6 Diplomacia ekonomike - Politika e jashtme në shërbim të zhvillimit

Politika e jashtme do të vihet drejtpërdrejt në shërbim të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Qeveria e PDK-së do të forcojë diplomacinë ekonomike për të tërhequr investime dhe për të mbështetur eksportet.

Kjo përfshin:

- promovimin aktiv të Kosovës si destinacion investimesh;
- përdorimin e rrjetit diplomatik për hapjen e tregjeve të reja;
- përkrahjen e bizneseve kosovare jashtë vendit.

10.7 Njohjet bilaterale dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare - Konsolidim i subjektivitetit shtetëror

Qeveria e PDK-së do të intensifikojë përpjekjet për sigurimin e njohjeve bilaterale dhe anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, si pjesë e konsolidimit të plotë të subjektivitetit ndërkombëtar.

Kjo do të realizohet përmes diplomacisë aktive, ndërtimit të aleancave dhe angazhimit të vazhdueshëm bilateral dhe multilateral.

Qeveria e PDK-së do të intensifikojë përpjekjet për **anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës**, duke forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe integritimin institucional evropian, si dhe do të punojë për **fitimin e statusit të vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian**, përmes reformave të thella, stabilitetit institucional dhe rikthimit të besueshmërisë së Kosovës në raport me Bashkimin Evropian.



10.8 Roli i diasporës - Fuqi diplomatike dhe ekonomike e Kosovës

Diaspora shqiptare është aset strategjik i Kosovës. Qeveria e PDK-së do të ndërtojë mekanizma institucionalë për përfshirjen aktive të diasporës në diplomaci, ekonomi dhe zhvillim.

Diaspora do të trajtohet si partner strategjik i shtetit.

10.9 Profesionalizimi i shërbimit diplomatik

Politika e jashtme do të udhëhiqet nga profesionalizmi, meritokracia dhe koordinimi institucional. Qeveria e PDK-së do të forcojë shërbimin diplomatik përmes trajnimeve, përzgjedhjes meritorë dhe qartësisë strategjike.

10.10 Politika e jashtme si garanci e stabilitetit dhe zhvillimit

Një politikë e jashtme e qëndrueshme garanton siguri, zhvillim dhe dinjitet shtetëror. Kosova do të rikthehet si partner i besueshëm, serioz dhe i respektuar në arenën ndërkombëtare.



PËRMBYLLJE

Kosova ka kaluar shumë. Ka kaluar periudha sfiduese, sakrifica të mëdha dhe momente vendimtare që e kanë formësuar si shtet dhe si shoqëri.

Sot, vendi ynë qëndron përballë një zgjedhjeje të rëndësishme: të vazhdojë rrugën e përçarjes, improvizimit dhe pasigurisë, ose të zgjedhë bashkimin, stabilitetin dhe përparimin e qëndrueshëm.

Ky program nuk është thjesht një dokument politik, por është pasqyrim i një vizioni të qartë për Kosovën që funksionon, për shtetin që u shërben qytetarëve dhe për shoqërinë që ecën përpara e bashkuar rreth vlerave të përbashkëta.

Ne besojmë se Kosova mund dhe duhet të jetë më mirë.

Më e drejtë.

Më e sigurt.

Më e zhvilluar.

Më e respektuar në botë.

Ky program ofron një plan të qartë për zhvillim ekonomik, për mirëqenie sociale, për siguri energjetike, për drejtësi të pavarur, për shëndetësi dhe arsim cilësor, për siguri publike dhe për një politikë të jashtme të besueshme dhe të koordinuar me aleatët tanë strategjikë.

Një program i ndërtuar mbi parimin e stabilitetit:

- stabilitet politik,
- stabilitet ekonomik,
- stabilitet shoqëror.

Stabiliteti nuk është qëllim në vetvete. Ai është kushti që i jep familjeve siguri për të ardhmen, që i jep bizneseve besim për të investuar dhe që i jep të rinjve arsye për të ndërtuar jetën e tyre këtu, në Kosovë.

Ne nuk premtojmë mrekulli.

Premtojmë punë të ndershme.

Vendime të përgjegjshme.

Dhe një qeverisje që i vendos interesat e qytetarëve mbi interesat e ngushta politike.

Ky është fillimi i një misioni të ri kombëtar:

- një mision për ta rikthyer besimin në institucione,
- për ta forcuar shtetin ligjor,
- për ta ndërtuar një ekonomi që krijon mirëqenie reale,
- dhe për ta pozicionuar Kosovën me dinjitet në familjen euroatlantike.

Ne besojmë në Kosovën që i mbron qytetarët e saj.

Në Kosovën që investon në fëmijët e saj.

Në Kosovën që i respekton punëtorët, pensionistët dhe familjet.

Në Kosovën që ndërton partneritete të forta dhe nuk izolohet.

Në Kosovën që bashkon dhe nuk përçan.

Ky program është ftesë për bashkim.

Ftesë për përgjegjësi.

Ftesë për përparim.

Le t'i lëmë pas ndasitë dhe ta ndërtojmë së bashku të ardhmen që e meritojmë.

Le ta bëjmë Kosovën një shtet që funksionon për të gjithë.

Një Kosovë të mundësive.

Një Kosovë të drejtësisë.

Një Kosovë të stabilitetit dhe shpresës.

Sepse vetëm **bashkë**, mund të ecim **përpara**.



**BASHKË.
PËRPARA.**

**BASHKË.
PËRPARA.**

